



Datë: 20.06.2025

Numër Protokollit: 4540/2025

A.nr.436/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.436/2025, të datës 10.03.2025, të parashtruar nga ankuesi A.P, kundër organit të punësimit/ Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, në çështjen juridike “*vlerësimi rezultateve në punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 20.06.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.436/2025, e datës 10.03.2025, e parashtruar nga ankuesi A.P, **anulohet** Formulari për vlerësimin e rezultateve në punës për ankuesen i datës 28.02.2025, dhe çështje kthehet në *rishqyrtim dhe rivendosje* tek vlerësuesi i ankuesit.

**II. Obligohet** Drejtorja Ekzekutive e Sekretarisë së Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, në cilësinë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankuesit, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit, të bëjë rivlerësimin e rezultateve në punë të ankuesit për vitin 2024 dhe atë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe pikëpamjet juridik si në arsyetim të këtij vendimi.

**III.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

## A r s y e t i m

Nëpunësi civil, A.P (tutje referuar vetëm ankuesja), më datë 10.03.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Formularit për vlerësimin e rezultateve në punës të datës 28.02.2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datës 19.03.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (*tutje referuar AKKVP*), ndërsa, kjo e fundit, më datë 02.04.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 1531/2025 të datës 10.03.2025, e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 28.02.2025; Dëshmi nga ankuesi për objektivin e parë; Lista e Investimeve kapitale buxheti 2023; Dëshmi nga ankuesi për objektivin e dytë; Planifikimi i zotimeve; Planifikimi i shpenzimeve; Kërkesë e prokurimit të iniciuara deri në korrik 2024; Kërkesë për shitje muajit shkurt 2024; Marrëveshjen e datës 08.02.2024 mes AKKVP dhe Policisë së Kosovës; Emailin e datës 02.04.2024 nga A.B për M.C dhe ankuesin; Emailin e datës 28.03.2024 nga ankuesi për A.B; Emailin e datës 02.07.2024 nga A.B për M.C; Emailin e datës 02.07.2024, 15.04.2024, 11.04.2024 nga ankuesi për A.B; Emailin e datës 18.07.2024 nga ankuesi për M.C; Emailin e datës 30.07.2024 nga ankuesi për A.B; Emailin e datës 29.07.2024 nga A.B për ankuesin; Inicimin për procedurën për sigurimin me roje korrik 2024; Vendimin Nr. ref:01039/24 i datës 19.07.2024; Emailin e datës 22.07.2024 nga F.G për ankuesin; Emailin e datës 02.07.2024 nga M.C për ankuesin Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 19.03.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 02.04.2025; Akt Emërimit e datës 01.01.2012; Përshkrimin e detyrave të punës Udhëheqës i Njësisë së Administratës; Të gjetura dhe rekomandimet e raportit të auditimit në AKKVP; Kërkesë për sigurimin e provës me ekspertizë nga Gjykata Komerciale datë 10.05.2024; Emailin e datës 27.03.2025 nga A.I për A.B; Emailin e datës 19.10.2023 nga ankuesi për A.I; Emailin e datës 19.10.2023 nga A.I për I.O dhe ankuesin; Kërkesat buxhetore 2024/02'Emailin e datës 11.09.2024 nga A.B për M.C; Emailin e datës 20.11.2024 nga A.B për ankuesin, D.R dhe B.L; Emailin e datës 21.06.2024 nga A.B për ankuesin, Y.B dhe V.E; Emailin e datës 20.06.2024 nga D.H për A.B; FOTO; Emailin e datës 01.12.2023 nga A.B për A.B, A.P dhe M.C; Emailin e datës 29.11.2023 nga A.B për A.B; Emailin e datës 31.03.2024, 24.05.2024, 23.05.2024 nga A.B për A.P; Emailin e datës 27.05.2024, 24.05.2024, 23.05.2024, 17.05.2024 nga anies për A.B; Emaili i datës 26.03.2025 nga A.I për A.B; Emaili i datës 23.05.2024 nga A.I për N.K, ankuesin etj për kërkesat buxhetor 2025 dhe listën; Emailin e datës 15.07.2024 nga ankuesi për A.I dhe M.C; Emailin e datës 05.02.2024 nga A.B për M.C, D.R dhe ankuesin; Emailin e datës 18.07.2024 nga A.B për ankuesin; Emailin e datës 17.07.2024 nga ankuesi për V.H; Emailin e datë s03.07.2024 nga V.H për ankuesin; Emailin e datës 03.07.2024 nga ankuesi për V.H; Emailin e datës 24.04.2024 nga A.B për ankuesin; Emailin e datës 22.04.2024 nga ankuesi për A.B; Emailin e datës 19.03.2024 nga A.B për ankuesin; Kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit datë 02.08.2024; Vendimin e datës 22.04.2025 për shtyhej të afatit për vendosje të ankesës; Vendimin Ref.01138/24 të datës 06.08.2024; Vendimin Ref.nr.01662/24 i datës 05.11.2024.

Kolegji i Këshillit pasi shqyrtimit dhe analizimit të provave materiale të çështjes vlerësoj që lënda të kthehet në **ri-shqyrtim** dhe **rivendosje** tek Drejtorja Ekzekutive e Sekretarisë së AKKVP-së, **sepse:**

Nga provat e administruara rrjedh së ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 01.01.2012, mbanë pozitën e punës *Udhëheqës i Njësitit të Administratës*, në AKKVP.

Tutje sipas shkresave të lëndës, rezulton se mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë e ankuesit më datë 28.02.2025 ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për vitin 2024 dhe të njëjtin e ka vlerësuar sipas nivelit të vlerësimit *Ka nevojë për përmirësim*.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton vlerësimin e rezultateve në punë të datës 28.02.2025, duke pretenduar së vlerësimi nuk është bërë real, ngase, ka përmbushur detyrat e punës dhe të gjitha objektivat, dhe së janë zbatuar të gjitha planet e prokurimit dhe të gjitha kërkesat janë realizuar. Kërkon që ankesa të aprovet të anulohet vlerësimi dhe të bëhet rivlerësimi.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pranueshmerinë e ankesës konstaton se e njëjta është e lejueshme në kuptim të nenit 52, paragrafi 17 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, dhe e njëjta është e pranueshme në kuptim të nenit 127 paragrafi 1 ndërlidhur me nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Ndërsa, në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore Kolegji i Këshillit, ju referuar Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, me theks të veçantë nenit 52, me të cilin është përcaktuar se: *1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i vazhdueshëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuara, vlerësimin e aftësisë profesionale, metodologjike, personale dhe sociale të nëpunëses/it civil në realizimin e objektivave dhe përmbushjen e përgjithshme të përgjegjësisë të njësisë. 2. Periudha e vlerësimit zgjat një (1) vit, nga 1 janari deri me 31 dhjetor. Procedura e dhënies së vlerësimit përfundon deri më 28 shkurt të vitit pasues. 3. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në: 3.1. realizimin e objektivave të paracaktuara në planin vjetor individual, përmbushjen e detyrave të punës në përputhje me përshkrimin përkatës të punës, objektivat e njësisë dhe institucionit, si dhe kryerjen e detyrave të atypëratyshme që nuk janë paracaktuar paraprakisht apo nuk kanë mundur të paracaktohen; 3.2. aftësitë profesionale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe sjelljen profesionale; 3.3. aftësitë metodologjike, personale dhe sociale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës. 4. Përcaktimi i objektivave individuale të nëpunëses/it civil bëhet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me nëpunësen/in dhe përfaqësuesen/in e njësisë së burimeve njerëzore, me shkrim, në muajin janar të çdo viti, së bashku me planin individual të punës për arritjen e këtyre objektivave. 5. Plani individual i punës i përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni, mund të rishikohet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, në bashkëpunim me nëpunësen/in civil. 6. Procedura e vlerësimit të rezultateve në punë përfshin dy (2) faza kryesore: 6.1. mbikëqyrjen e vazhdueshme të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë; 6.2. vlerësimin vjetor të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore. 7. Performanca e nëpunëses/it civil të kategorisë profesionale dhe kategorisë së specialistes/it vlerësohet nga mbikëqyrësja/ie saj/tij i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore. 8..10. Përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, merr pjesë, mbështet dhe vëzhgon çdo proces të vlerësimit. 11. Mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë gjatë procesit të vlerësimit është e/i obliguar të vlerësojë nëpunësen/in në mënyrë objektive dhe të argumentojë vlerësimin. 12. Në fund të periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore zhvillojnë takim me nëpunësen/in për vlerësimin e rezultateve të punës. Pas takimit, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë aprovon formularin e vlerësimit që e nënshkruajnë të gjitha palët”*

Kolegji i Këshillit nga analizimi i provave materiale të parashtruara nga palët në procedurë ka gjetur së ankuesi është vlerësuar për tërë vitin 2024, edhe pse ankuesi nuk e kishte ushtruar detyrën e Udhëheqësit të Administratës nga data 06.08.2024, për arsye së ankuesi për shkak të inicimit të procedurës disiplinore ndaj tij nga mbikëqyrësja e drejtpërdrejtë fillimisht sipas Vendimit Ref. 01138/24 të datës 06.08.2024 të Komisionit Disiplinor të AKKVP-së, ishte pezulluar nga puna, ndërsa më Vendimin Ref:01633/24 të datës 31.10.2024, të Komisionit Disiplinor ishte shpallur përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore dhe i është shqiptuar masa disiplinore *Ulje në pozitë*, vendim të cilin Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e kishte anuluar më Vendimin A.nr.1736/2024 të datës 24.12.2024, duke e kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje tek Komisioni Disiplinor. Pra, si pasojë e këtyre veprimeve ankuesi nga data 06.08.2024, nuk ka ushtruar pozitën e tij përkatëse sipas akt emërimit, sepse ekzekutimin i vendimeve të Komisionit Disiplinor nuk ishte pezulluar në kuptim të nenit 144 ndërlidhur me nenin 130 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Sipas shkresave të lëndës ankuesi është vlerësuar për vitin 2024 lidhur me veprimet që janë bërë në vitin 2023, lidhur me mos përfundimin e procedurave të prokurimit për sigurimin me roje, ankuesi ka ndërmarr veprim për hapjen e procedurës së prokurimit për sigurimin e rojeve në korrik të vitit 2024 pas kërkesës së mbikëqyrësit, mirëpo duke qenë se nga data 06.08.2024 nuk ka ushtruar pozitë, atëherë nuk ka mundur ta finalizoj këtë proces, kështu që edhe i njëjti nuk mund të vihet në përgjegjësi për një periudhë kohore që nuk ka qenë duke e ushtruar pozitën.

Lidhur me vlerësimin për objektivën e menaxhimit të lëndëve, Kolegji në bazë të provave ka gjetur se sipas Vendimit Nr. Re. 01039/24 të datës 19.07.2024, është emëruar Komisionin për Përzgjedhjen e Lëndës Arkivore dhe Asgjësimin e Materiale të Pavlefshëm Regjistraturik ku ankuesi ka qenë kryesues i këtij komisioni në cilësinë e Udhëheqësit të Administratës, mirëpo, që ankuesi është pezulluar nga puna më datë 06.08.2024, pra edhe këtë objektive ankuesi nuk ka mundur ta përfundoj.

Andaj, mbi gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, rrjedh se vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesin nuk është i drejtë, sepse ankuesi vlerësohet për tërë vitin 2024, ndërsa për arsyet siç u tha më sipër ankuesi pozitën e punës për të cilën është vlerësuar nuk e ka ushtruar gjatë tërë vitit 2024 andaj, në vështrim të dritës së fakteve dhe procedurave ligjore, Drejtorja Ekzekutive e Sekretarisë së AKKVP-së, në cilësinë e mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë të ankueses, është e obliguar që të bëjë rivlerësimin e ankuesit vetëm lidhur me periudhën për të cilën ankuesi ka ushtruar pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Administratë, dhe vlerësimi i objektivave dhe aftësive duhet të jetë i drejtë dhe i argumentuar saktë.

Kështu që, duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

***Këshillë juridike:*** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

## **KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

*Lënda me numër A.nr.436/2025*

**Avdyl BEKTESHI**

**Procesmbajtës**

**Ardita Haxhnikaj-DEMI**

**Kryetare e Kolegjit**

### **Vendimi i dërgohet:**

- *Ankuesit A.P;*
- *Organit të punësimit: Drejtorja Ekzekutive e Sekretarisë dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të AKKVP-së; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*